

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Albanian Energy Supplier Sh.p.k.
Rruga Brigada e 8, Pallati 19, Kati 3, Ap.3, Tirane, Shqipëri,
Regjistruar pranë regjistrit tregtar me numër identifikimi
L42304017T

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, me 01.07.2022 (dy mijë e njëzet e dy), në orën 13:00, në selinë e Shoqërisë “Albanian Energy Supplier” Sh.p.k. (më tej referuar si “Shoqëria”), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me të pranishëm:

- Shoqëria “**Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k**” Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me **NUIS K72223031K** dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 12, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, me administratore, znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, e lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër personal I35203147R, - ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të saj.
- Znj. Eva Veizaj, ne cilësinë e personit te ftuar.

Meqenëse në mbledhje merr pjesë Ortaku që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë konsiderohet e mbledhur rregullisht dhe vendimet e marra plotësisht të vlefshme.

Znj. Edlira Muka, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Eva Veizaj, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË;
- II. TE NDRYSHME;

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm parashtron se Kapitali aktual i Shoqërisë është 6,000,000.00Lek (Gjashtë milion lekë), dhe për motive operacionale është parë e arsyeshme zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë me një vlerë prej me 5,999,000.00 Leke (Pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë Lekë). Pas zvogëlimit, kapitali i Shoqërisë nga vlera 6,000,000.00Lek (Gjashë milion lekë) do të bëhet në një vlerë prej 1,000.00 Leke (Një mijë Lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOS:

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me **5,999,000.00 Leke (Pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë Lekë);**
- B. Kapitali i ri i shoqërisë do të jetë **1,000.00 Leke (Një mijë Lekë);**
- C. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme online me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim;

Megjenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 13.30.


Ky Vendim i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Albanian Energy Supplier" Shpk mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

ALBANIAN ENERGY SUPPLIER SH.P.K




KRYETARI


Znj. Edlira MUKA
Administratore

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.

SEKRETARI


Znj. Eva Veizaj